

VENDIM
Nr. 102, datë 20.3.2023

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 38, DATË 20.2.2023, “MBI FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 185, SERIA PV12K, PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË “ENERGJI-XHAÇI” SHPK”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 953/2 prot., datë 17.3.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 20.2.2023, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energji-Xhaçi” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 38, datë 20.2.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energji-Xhaçi” sh.p.k., për arsye të mosshlyerjes në afat të pagesës rregullore të vitit 2022 për licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe po ashtu nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 953 prot., datë 27.2.2022, shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38/2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezultojnë se kjo debi është shlyer në datën 7.3.2023.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dënimin e subjektit, rezultojnë se shoqëria “Energji-Xhaçi” sh.p.k. i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës”.

- Në nenin 95 i “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet, se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “Energji-Xhaçi” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës të prapambetur fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i është vendosur masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës dhe duke qenë se objekti për të cilin filloi procedura për heqjen e licencës së të licencuarit nuk ekziston më, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 38/2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 20.2.2023, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Energji-Xhaçi’ sh.p.k.”.
2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 20.2.2023.
3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Energji-Xhaçi” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti